



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 160

1 tetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 46/2013 datë 26.9.2013	Për zgjedhjen e deputetit Vangjel Dule Zëvendëskryetar i Kuvendit. 7217
Vendim i Kuvendit nr. 47/2013 datë 26.9.2013	Për caktimin e përbërjes së sekretariateve të Kuvendit..... 7217
Vendim i Kuvendit nr. 48/2013 datë 26.9.2013	Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit..... 7218
Dekret nr. 8332 datë 20.9.2013	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar bashkie, bashkia Korçë, qarku Korçë..... 7222
Dekret nr. 8333 datë 27.9.2013	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar bashkie, komuna Karbunarë, qarku Fier..... 7222
Vendim i KM nr. 817, datë 5.9.2013	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Sulejman Mato.. 7223
Udhëzim i MAS nr. 50, datë 20.9.2013	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2013-2014..... 7223
Vendim i ERE nr. 84, datë 6 .9.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2”..... 7225

Vendim i ERE nr. 85, datë 6.9.2013	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Zall Herr Energji 2001” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7225
Vendim i ERE nr. 86, datë 6.9.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Cekrez 1” dhe “Cekrez 2” si burim i rinovueshëm energjie.....	7226
Vendim i ERE nr. 87, datë 6.9.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Qarr” dhe “Kaltanj”	7227
Vendim i ERE nr. 88, datë 6.9.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Qarr” dhe “Kaltanj” si burim i rinovueshëm energjie.....	7228
Vendim i ERE nr. 89, datë 6.9.2013	Për licencimin e shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Shutine”.....	7229
Vendim i ERE nr. 90, datë 6.9.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “DN & NAT Energji” sh.p.k. me nr. 128, seria PV11P, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 58, datë 22.6.2011.....	7230
Vendim i ERE nr. 91, datë 6.9.2013	Për licencimin e shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	7230
Vendim i ERE nr. 92, datë 6.9.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Koka 1”, të shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie..	7231
Vendim i ERE nr. 93, datë 6.9.2013	Për licencimin e shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7232
Vendim i ERE nr. 94, datë 6.9.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Shutine”, të shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie.....	7233
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Halluni.....	7233

VENDIM
Nr. 46/2013

PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETIT VANGJEL DULE ZËVENDËSKRYETAR I KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të neneve 8 pika 2 dhe 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Deputeti Vangjel Dule zgjidhet në detyrën e Zëvendëskryetarit të Kuvendit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir META

Miraturar në datën 26.9.2013

VENDIM
Nr. 47/2013

PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të neneve 10 dhe 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Përbërja e sekretariateve të Kuvendit është si më poshtë:

Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit:

1. Anastas Angjeli	Sekretar	PS
2. Sherefedin Shehu	Sekretar	PD
3. Përparim Spahiu	anëtar	LSI
4. Ervin Koçi	anëtar	PS
5. Florion Mima	anëtar	PD

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet

1. Armando Subashi	Sekretar	PS
2. Vangjel Tavo	anëtar	LSI
3. Arben Ristani	anëtar	PD

Sekretariati për Statusin e Deputetit

1. Taulant Balla	Sekretar	PS
2. Robert Bitri	anëtar	LSI
3. Eduard Halimi	anëtar	PD



Sekretariati për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare

1. Fatmir Toçi	Sekretar	PS
2. Luan Rama	anëtar	LSI
3. Eleina Qirici	anëtare	PD

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë

1. Mimoza Hafizi	Sekretare	PS
2. Monika Kryemadhi	anëtare	LSI
3. Jozefina Topalli	anëtare	PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir META

Miraturar në datën 26.9.2013

VENDIM
Nr. 48/2013

PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 pika 1 dhe 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve, të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe e kryesive të tyre është si më poshtë:
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

1. Fatmir Xhafaj	Kryetar	PS
2. Oerd Bylykbashi	Zëvendëskryetar	PD
3. Armando Subashi	Sekretar	PS
4. Bashkim Fino	anëtar	PS
5. Blendi Klosi	anëtar	PS
6. Petrit Vasili	anëtar	LSI
7. Dashamir Peza	anëtar	PS
8. Ermonela Felaj	anëtare	PS
9. Pandeli Majko	anëtar	PS
10. Spartak Braho	anëtar	LSI
11. Tom Doshi	anëtar	PS
12. Ulsi Manja	anëtar	PS
13. Vasilika Hysi	anëtare	PS
14. Vexhi Muçmataj	anëtar	PS
15. Mark Frroku	anëtar	PS
16. Armando Prenga	anëtar	PS
17. Pirro Lutaj	anëtar	PS
18. Xhemal Qefalia	anëtar	PS

19. Arben Ristani	anëtar	PD
20. Tahir Muhedini	anëtar	PDIU
21. Gjovalin Bzhetaj	anëtar	PDIU
22. Luan Duzha	anëtar	PR
23. Eduard Halimi	anëtar	PD
24. Edi Paloka	anëtar	PD
25. Keltis Kruja	anëtar	PD
26. Gent Strazimiri	anëtar	PD
27. Sokol Olldash	anëtar	PD
28. Kastriot Islami	anëtar	PD
29. Nard Ndoka	anëtar	I pavarur

Komisioni për Integrimin Europian

1. Majlinda Bregu	Kryetare	PD
2. Taulant Balla	Zëvendëskryetar	PS
3. Monika Kryemadhi	Sekretare	LSI
4. Gramoz Ruçi	anëtar	PS
5. Valentina Leskaj	anëtare	PS
6. Arta Dade	anëtare	PS
7. Ben Blushi	anëtar	PS
8. Namik Dokle	anëtar	PS
9. Gerti Bogdani	anëtar	PD
10. Arben Ristani	anëtar	PD
11. Jorida Tabaku	anëtare	PD

Komisioni për Politikën e Jashtme

1. Arta Dade	Kryetare	PS
2. Aldo Bumçi	Zëvendëskryetar	PD
3. Namik Dokle	Sekretar	PS
4. Ben Blushi	anëtar	PS
5. Gramoz Ruçi	anëtar	PS
6. Valentina Leskaj	anëtare	PS
7. Olta Xhaça	anëtare	PS
8. Përparim Spahiu	anëtar	LSI
9. Jozefina Topalli	anëtare	PD
10. Arben Imami	anëtar	PD
11. Vangjel Dule	anëtar	I pavarur
12. Eduard Selami	anëtar	PD
13. Kastriot Islami	anëtar	PD
14. Shpëtim Idrizi	anëtar	PDIU
15. Fatmir Mediu	anëtar	PR

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

1. Erion Braçe	Kryetar	PS
2. Ridvan Bode	Zëvendëskryetar	PD
3. Anastas Angjeli	Sekretar	PS
4. Arben Çuko	anëtar	PS
5. Andrea Marto	anëtar	PS
6. Ervin Koçi	anëtar	PS
7. Agron Çela	anëtar	LSI
8. Evis Kushi	anëtar	PS
9. Ilir Xhakolli	anëtar	PS
10. Koço Kokëdhima	anëtar	PS
11. Majlinda Bufi	anëtare	PS



12. Paulin Sterkaj	anëtar	PS
13. Pjerin Ndreu	anëtar	PS
14. Përparim Spahiu	anëtar	LSI
15. Florion Mima	anëtar	PD
16. Gjovalin Kadeli	anëtar	PR
17. Sherefedin Shehu	anëtar	PD
18. Edmond Spaho	anëtar	PD
19. Liljana Elmazi	anëtare	PD
20. Dashamir Shehi	anëtar	PD
21. Albana Vokshi	anëtare	PD
22. Jorida Tabaku	anëtare	PD
23. Igli Cara	anëtar	PD

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

1. Spartak Braho	Kryetar	LSI
2. Flamur Noka	Zëvendëskryetar	PD
3. Pirro Lutaj	Sekretar	PS
4. Arben Çuko	anëtar	PS
5. Armando Prenga	anëtar	PS
6. Paulin Sterkaj	anëtar	PS
7. Shkëlqim Selami	anëtar	LSI
8. Luan Rama	anëtar	LSI
9. Pjerin Ndreu	anëtar	PS
10. Taulant Balla	anëtar	PS
11. Xhemal Qefalia	anëtar	PS
12. Ermonela Felaj	anëtare	PS
13. Ulsi Manja	anëtar	PS
14. Vexhi Muçmataj	anëtar	PS
15. Armando Subashi	anëtar	PS
16. Alban Zeneli	anëtar	PDIU
17. Aqif Rakipi	anëtar	PDIU
18. Ylli Shehu	anëtar	PR
19. Mesila Doda	anëtare	PD
20. Ardian Turku	anëtar	PD
21. Astrit Patozi	anëtar	PD
22. Keltis Kruja	anëtar	PD
23. Helidon Bushati	anëtar	PD

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

1. Eduard Shalsi	Kryetar	PS
2. Genc Ruli	Zëvendëskryetar	PD
3. Robert Bitri	Sekretar	LSI
4. Artan Gaçi	anëtar	PS
5. Artur Bushi	anëtar	PS
6. Piro Kapurani	anëtar	LSI
7. Besnik Baraj	anëtar	PS
8. Gentian Bejko	anëtar	PS
9. Namik Kopliku	anëtar	PS
10. Parid Cara	anëtar	PS
11. Rakip Suli	anëtar	PS
12. Sadri Abazi	anëtar	PS
13. Ervin Koçi	anëtar	PS
14. Fatmir Toçi	anëtar	PS

15. Ilir Xhakolli	anëtar	PS
16. Dashamir Tahiri	anëtar	PDIU
17. Besnik Dusha	anëtar	PR
18. Agron Duka	anëtar	PR
19. Sokol Olldashi	anëtar	PD
20. Ardian Turku	anëtar	PD
21. Sherefedin Shehu	anëtar	PD
22. Voltana Ademi	anëtare	PD
23. Gjergji Papa	anëtar	PD
24. Kozma Dashi	anëtar	PD
25. Helidon Bushati	anëtar	PD

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

1. Albana Vokshi	Kryetare	PD
2. Klodiana Spahiu	Zëvendëskryetare	PS
3. Vangjel Tavo	Sekretar	LSI
4. Eduart Bejko	anëtar	PS
5. Ilir Pendavinji	anëtar	PS
6. Andrea Marto	anëtar	PS
7. Olta Xhaçka	anëtare	PS
8. Musa Ulqini	anëtar	PS
9. Bujar Kllogjri	anëtar	LSI
10. Ylli Ziçishti	anëtar	PS
11. Halim Kosova	anëtar	PD
12. Roland Keta	anëtar	PD
13. Albina Deda	anëtare	PD
14. Florion Mima	anëtar	PD
15. Myqerem Tafaj	anëtar	PD
16. Omer Mamo	anëtar	PDIU

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

1. Genc Pollo	Kryetar	PD
2. Alfred Peza	Zëvendëskryetar	PS
3. Mimoza Hafizi	Sekretare	PS
4. Fatmir Toçi	anëtar	PS
5. Fidel Ylli	anëtar	PS
6. Musa Ulqini	anëtar	PS
7. Gledion Rehovica	anëtar	LSI
8. Ylli Ziçishti	anëtar	PS
9. Luiza Xhuvani	anëtare	PS
10. Klodiana Spahiu	anëtare	PS
11. Ilir Pendavinji	anëtar	PS
12. Myqerem Tafaj	anëtar	PD
13. Bedri Hoxha	anëtar	PR
14. Luçiano Boçi	anëtar	PD
15. Astrit Veliaj	anëtar	PD
16. Eleina Qirici	anëtare	PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir META

Miratuar në datën 26.9.2013



DEKRET
Nr. 8332, datë 20.9.2013

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE, BASHKIA KORÇË,
QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10 paragrafi 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar),

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 3 nëntor 2013, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të bashkisë Korçë, qarku Korçë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8333, datë 27.9.2013

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE, KOMUNA
KARBUNARË, QARKU FIER**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10 paragrafi 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar),

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 3 nëntor 2013, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të komunës Karbunarë, qarku Fier.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 817, datë 5.9.2013

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. SULEJMAN MATO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Sulejman Mato, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 50, datë 20.9.2013

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” ME KOHË TË PJESSHME, NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2013-2014**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 743, datë 5.9.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2013-2014”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe të shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve brenda vendit, si dhe shqiptarëve nga trojet jashtë kufijve, në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2013-2014, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimi dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme. Procesi monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit për kandidatët brenda vendit, si dhe shqiptarëve nga trojet jashtë kufijve, që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme, datat dhe oraret, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.



4. Aplikimet për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data 23.9.2013 deri në datë 7.10.2013, prej orës 08:00 deri në orën 16:00, ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve, të shoqëruar me listën origjinale të notave.

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës.

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi të tarifës së regjistrimit prej 2500 lekë, paguar në Postën Shqiptare.

e) Deklaratë e kandidatit që vërteton se nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucionet e arsimit të lartë publik.

5. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë për çdo program studimi të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme të ngrihen komisione *ad-hoc* sipas fushave përkatëse, për përzgjedhjen e aplikantëve fitues në përputhje me kriteret e pranimi të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.00 të datës 20.10.2013, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara sipas vendimit nr. 743, datë 5.9.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2013-2014”.

7. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 21.10.2013 deri në datën 28.10.2013, prej orës 08:00 deri në orën 16:00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të paraqesë në origjinal dokumentet sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 4 të këtij udhëzimi.

8. Me mbylljen e regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme, të plotësuar sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar.

Kandidatët që rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi të ciklit të parë ose të dytë, me kohë të plotë apo të pjesshme, në IAL-të publike, nuk marrin numër matrikulimi. AKP-ja pas verifikimit, i kërkon IAL-ve t'i çregjistrojë ata.

9. Ngarkohen Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRE E ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

VENDIM
Nr. 84, datë 6.9.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ZALL HERR
ENERGJI 2011” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HECET “CEKREZE 1” DHE “CEKREZE 2”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Neni 9 pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera, është plotësuar plotësisht.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Cekrez 1” dhe “Cekrez 2”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM
Nr. 85, datë 6.9.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ZALL HERR
ENERGJI 2001” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë



9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Zall Herr Energji 2001” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Zall Herr Energji 2001” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Zall Herr Energji 2001” sh.p.k. për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM

Nr. 86, datë 6.9.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ZALL HERR ENERGJI 2011” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HECET “CEKREZ 1” DHE “CEKREZ 2” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “II”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Cekrez 1” dhe “Cekrez 2” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Cekrez 1” dhe “Cekrez 2” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM

Nr. 87, datë 6.9.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET “QARR” DHE “KALTANJ”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gjerat “a”, të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 gjerat “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gjerat “a” dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 gjerat “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Qarr & Kaltanaj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidrocentrali Qarr&Kaltanaj” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Neni 9 pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera
Është plotësuar pjesërisht. Është në proces miratimi i pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes dhe marrja e lejes së përdorimit të ujit.
Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidrocentrali Qarr& Kaltan” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Qarr” dhe “Kaltan”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo**

**VENDIM
Nr. 88, datë 6.9.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES PËR HECET “QARR” DHE “KALTANJ” SI BURIM I RINOVUESHËM
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 18.3.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Qarr&Kaltan” sh.p.k. për kualifikimin e implantit prodhues për hecet “Qarr” dhe “Kaltan” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Qarr&Kaltan” sh.p.k. është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltan” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Qarr” dhe “Kaltan” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM
Nr. 89, datë 6.9.2013

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SHUTINA ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHUTINE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Shutina” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Shutina Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Shutine” me fuqi 2.4 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo



VENDIM
Nr. 90, datë 6.9.2013

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “DN & NAT ENERGJI” SHPK ME NR. 128, SERIA PV11P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 58, DATË 22.6.2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3, pika 4, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 128, seria PV11P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 58, datë 22.6.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “DN & NAT Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15 pika 4 germa “a”:

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15 pika 4 germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “DN & NAT Energji” me nr. 128, seria PV11P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Kumbull Merkurth” me fuqi 630 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 58, datë 22.6.2011.

2. Fuqia e instaluar e hec “Kumbull Merkurth” nga 630 KW të bëhet 830 KW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM
Nr. 91, datë 6.9.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 45 pika 4, dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit,

modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Snow Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM Nr. 92, datë 6.9.2013

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “KOKA 1”, TË SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a”, të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Koka 1”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”
Është plotësuar tërësisht.
- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”
Është plotësuar tërësisht.



- Neni 7, pika 3, germa “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për hec “Koka 1”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo**

**VENDIM
Nr. 93, datë 6.9.2013**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DANS ENERGY ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8, 9, 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Dans Energy Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo**

VENDIM
Nr. 94, datë 6.9.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “SHUTINE”, TË SHOQËRISË
“SHUTINA ENERGJI” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Shutine”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për hec “Shutine” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

KËRKESË

Shtetasja Brunilda Gorishti kërkon pranë Gjikatës së Rrethit Tiranë shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Ilir Halluni, i biri i Dionisit, lindur në Tiranë, i datëlindjes 3.2.1968, si dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Brunilda Gorishti (Halluni)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 1.10.2013
Doli nga shtypi më 1.10.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 20 lekë